



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Mbrojtjes
Ministarstvo za Odbrane / Ministry Of Defense



RAPORT VJETOR 2023

VITI I SUKSESEVE TË USHTRISË

Prishtinë, 2023

PËRMBAJTA

OBJEKTIVAT STRATEGJIKË TË MINISTRIT TË MBROJTJES 2021-2025	3
VITI 2023 - VITI I SUKSESEVE TË USHTRISË	4
NJË VIT I SUKSESSHËM NË TRAJNIMET NDËRKOMBËTARE	9
NË FSK GJATË VITIT 2023 JANË PRANUAR 628 REKRUTË TË RINJ	10
ARSIMIMI DHE STËRVITJA: SHTYLLA KRYESORE E PROFESIONALIZMIT NË FSK	11
PËRPARIMET NË DOKUMENTET STRATEGJIKË TË MBROJTJES SË KOSOVËS PËR 2023	13
RRITJA E KAPACITETEVE TË FSK-SË PËRMES DONACIONEVE NDËRKOMBËTARE	14
INVESTIME TË REJA DHE PËRMIRËSIMI I KAPACITETEVE LOGJISTIKE DHE INFRASTRUKTURE PËR RRITJEN E AFTËSIVE OPERACIONALE TË FSK-SË.....	15
MM DHE FSK TË PËRKUSHTUAR NË BASHKËPUNIMIN E SHKËLQYESHËM CIVILO– USHTARAK	16
REALIZIMI I SUKSESSHËM I AKTIVITETEVE TË PARAPARA NË PLANIN VJETOR TË PUNËS PËR MM-NË	17
FSK ME RRITJE PROFESIONALE DHE MODERNIZIM TË PAJISJEVE	18
EFIKASITETI I MENAXHIMIT TË DOKUMENTEVE NË VITIN 2023	19
SIGURIA KIBERNETIKE NË FOKUS: MBËSHTETJE NDËRKOMBËTARE PËR HARTIMIN E KURRIKULËS PËR QENDRËN SHTETËRORE TRAJNUESE PËR SIGURI KIBERNETIKE	20
AVANCIMI I KAPACITETEVE MJEKËSORE NË FSK PËRMES BASHKËPUNIMIT ME INSTITUCIONET VENDORE DHE NDËRKOMBËTARE	21
PËRFAQËSIMI I GRAVE DHE VAJZAVE NË MM DHE FSK KA PRANI STANDARDE TË KRAHASUAR ME VENDET E RAJONIT DHE NATO-S.....	23
IMPLEMENTIMI I STRATEGJISË PËR INTEGRIMIN E KOMUNITETEVE JO-SHUMICË	24
PROFESIONALIZËM DHE OBJEKTIVITET NË KOMUNIKIMIN ME PUBLIKUN DHE MEDIAT	25
PROTOKOLLI INSTITUCIONAL DHE SHTETËROR I NIVELIT TË LARTË	26

OBJEKTIVAT STRATEGJIKE TË MINISTRIT TË MBROJTJES 2021-2025



- Fuqizimi i mbikëqyrjes demokratike civile dhe rritja e llogaridhënies dhe transparencës.
- Zhvillimi i kapaciteteve ushtarake në funksion të mbrojtjes së sovranitetit dhe integritetit territorial.
- Zgjerimi i bashkëpunimit bilateral, anëtarësimi në organizata dhe pjesëmarrja në operacione ndërkombëtare.
- Mbajtja e kapaciteteve thelbësore në funksion të mbështetjes ushtarake autoriteteve civile.

VITI 2023-VITI I SUKSESEVE TË USHTRISË

Gjatë gjithë vitit 2023, Ministria e Mbrojtjes dhe FSK thelluan e zgjeruan miqësinë e partneritetin maksimal me aleatin tonë kryesor, SHBA-në dhe shumë partnerë tjerë.

Për këta muaj, u realizua një bashkëpunim intensiv ndërkombëtar i lidhshëm të MM-së dhe FSK-së, ku dëshmuam se jemi të pandalshëm dhe drejt realizimit të qëllimit tonë strategjik- zhvillimin dhe forcimin e Ushtrisë sonë, për realizimin e plotë të misionit kushtetues dhe ligjor.



Ministri i Mbrojtjes dhe Komandanti i FSK-së, në kuadër të përgjegjësiwe zyrtare, kanë vazhduar me aktivitetet e përfaqësimit ndërkombëtar gjatë gjithë vitit.

Duke qenë se vlerësojmë lartë bashkëpunimin me partnerët tanë strategjik dhe synimi ynë është anëtarësimi në NATO, Ministria e Mbrojtjes, si pjesë e barabartë e Grupit të Kontaktit në Mbështetje të Ukrainës, e udhëhequr nga SHBA-ja, gjatë vitit 2023 ka vazhduar pjesëmarrjen e saj në takimet e organizuara.



Po ashtu, gjatë këtij viti janë arritur shtatë marrëveshje ndërkombëtare ndërinstitucionale me Shqipërinë, SHBA-së, Turqinë, Gjermaninë, Kroacinë, Britaninë e Madhe, Irlandën Veriore dhe është në proces të zhvillimit të marrëveshjes SOFA me Jordaninë. Janë koordinuar planet bilaterale vjetore me shtetet partnere për trajnime dhe aktivitete të vitit 2024.



Gjatë këtij viti, në Ministrinë e Mbrojtjes u pritën personalitet të çmuara si: ministri i Forcave të Armatosura të Britanisë së Madhe, James Heappey, ministri i Mbrojtjes Kombëtare të Republikës së Turqisë, Yaşar Güler, ushtruesi i detyrës së Ministrit të Mbrojtjes të Malit të Zi, Filip Adzic, Ndihmës Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s për Operacione, Thomas Goffus, drejtori i Divizionit të Operacioneve dhe Planifikimit të Shtabit Usharak Ndërkombëtar në Shtabin e NATO-s, gjeneralmajor Ulf Haeussler, shefi i Stafit të Mbrojtjes së Italisë dhe kryesuesi i ardhshëm i Komitetit të NATO-s, admiral Giuseppe Cavo Dragone, Komandanti në largim i Gardës Kombëtare të Iowas-s, gjeneral major Benjamin J. Corell dhe Komandantin e Gardës Kombëtare të Iowas-s, gjeneral brigade Stephen Osborn, etj.



Gjatë vitit, po ashtu u realizuan edhe shumë vizita pune të rëndësishme siç është pjesëmarrja e ministrit të Mbrojtjes, Ejup Maqedonci në takimin e Ministrave të Mbrojtjes të vendeve anëtare të SHBA-Kartës së Adriatikut (A5), pjesëmarrja në punimet e forumit ndërkombëtar të sigurisë në Halifax të Kanadasë, takimi në Departamentin e Shtetit nga Ndihmëssekretari i Shtetit për Çështje Evropiane dhe Euroaziatike, James O'Brien, pjesëmarrja në Takimin e Ministrave të Mbrojtjes të iniciativës së Bashkëpunimit të Mbrojtjes së Evropës Qendrore (CEDC), etj.

Poashtu, në këtë vit janë arritur dy marrëveshje të bashkëpunimit me Shqipërinë, që kanë të bëjnë për bashkëpunim në fushën e mjekësisë ushtarake si dhe lehtësimin e procedurave të kalimit transit të mallrave ushtarake për qëllime dhe nevoja të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë.

Në këtë vit kanë zbarkuar dy kontingjente të FSK-së në Ishujt Falkland së bashku me Mbretërinë e Bashkuar.

Në proces të finalizimit është Marrëveshja implementuese ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes së Mbretërisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Kosovës lidhur me përfshirjen e FSK-së në Operacion INTERFLEX për trajnim të ushtrisë Ukrainase. Gjithashtu, është në proces të koordinimeve me Mbretërinë e Bashkuar për bashkë zbarkim të FSK-së me ushtrinë britanike në shtetin e Belizesë nga muaji prill 2024, etj. Gjatë këtij viti, FSK ka vazhduar pjesëmarrjen në ushtrimet së bashku me ushtrinë e SHBA-së dhe shteteve partnere.



KOSOVA NË MESIN E VENDEVE PRITËSE DHE TRUPAT E FSK-SË PJESËMARRËSE NË STËRVITJEN ME TË MADHE AMERIKANE NË EVROPË “DEFENDER-EUROPE '23”

Më 21 maj, në sheshin “Skënderbeu” në Prishtinë është mbajtur ceremonia e fillimit të ushtrimit më të madh ndërkombëtar ushtarak “Defender Europe '23”, me ç'rast FSK të tregoi kapacitetet e saja luftarake, e po ashtu shkallën e ndërveprimit ushtarak. Në këtë ceremoni morën pjesë personalitetet më të larta shtetërore. Ushtrimi ndërkombëtar ushtarak “Defender Europe '23” është mbajtur nga data 21 maj deri me 2 qershor, ku pjesëmarrës ishin 25 shtete me mbi 22 mijë ushtarë. Republika e Kosovës si vend pritës kishte mbi 1300 ushtarë.



FSK DHE PARTNERËT 2023 “KOSOVA ËSHTË SUKSESI YNË I PËRBASHKËT”

Ministria e Mbrojtjes dhe Shtabi i Përgjithshëm i FSK-së, në muajin tetor mbajtën konferencën vjetore ndërkombëtare “FSK dhe partnerët 2023”, me moton “Kosova është sukcesi ynë i përbashkët”, ku morën pjesë ambasadorë, atashe të mbrojtjes dhe përfaqësues tjerë diplomatikë dhe ushtarakë të të gjitha shteteve partnere të Republikës së Kosovës.

Në këtë konferencë u theksua se Republika e Kosovës, Ministria e Mbrojtjes dhe FSK janë të vendosura që të vazhdojnë dhe rrisin bashkëpunimin me partnerët, për të formësuar rrugën drejt integritit në institucionet euro-atlantike dhe në NATO dhe se roli i partnerëve në këtë drejtim nuk është vetëm i rëndësishëm, por themelor dhe vendimtar.



NJË VIT I SUKSESSHËM NË TRAJNIMET NDËRKOMBËTARE

Sa i përket aspektit të paraqitjes ndërkombëtare të Kosovës, gjatë vitit 2023, Qendra Ndërkombëtare e Trajnimit për Kërkim-Shpëtim e Gardës Kombëtare të FSK-së ka korrur suksese të jashtëzakonshme. Vetëm gjatë këtij viti kjo Qendër ka trajnuar qindra pjesëtarë të shteteve partnere si: Shqipëria, Mbretëria e Bashkuar, Italia, Hungaria, Jordania, Malta, Maqedonia Veriore, Irlanda, Portugalia, Turqia, dhe së fundi Holanda, shtet me të cilin dhe filluam etapën e re të ofrimit me pagesë të trajnimeve në QNTKSH.

Gjithsej, në vitin 2023 janë realizuar 20 operacione të kërkim-shpëtimit. Me rastin e tërmetit shkatërrues në Turqi, të ndodhur në muajin shkurt të 2023 FSK ka dërguar ekipet e kërkim-shpëtimit, ku ata treguan profesionalizëm, përkushtim dhe performancë të lartë që rezultoi me shpëtimin e katër jetëve të qytetarëve të Republikës së Turqisë.

Gjithashtu është realizuar operacioni humanitar për kërkim- shpëtim në ujëra në lumin Buna në Shkodër të Shqipërisë në muajin dhjetor 2023.



RRJETI I RI I DIPLOMACISË USHTARAKE TË KOSOVËS PËR 2023

Gjatë vitit 2023 është zgjeruar rrjeti i diplomacisë ushtarake përmes akreditimit të atashëve tanë ushtarakë ku është bërë akreditimi i atashëve jo-rezidentë të Republikës së Kosovës për SHBA, Kanada dhe Slloveni. Po ashtu, është bërë akreditimi i atashëut të Mbrojtjes së Republikës së Kosovës në Holandë dhe është në proces të koordinimit të akreditimit të atashëve të Mbrojtjes së Republikës së Kosovës për Zvicër dhe Itali.



NË FSK GJATË VITIT 2023 JANË PRANUAR 628 REKRUTË TË RINJ

Procesi i rekrutimit të rekrutëve i filluar në vitin 2022 ka përfunduar në vitin 2023, ku janë përzgjedhur dy gjenerata të rekrutëve prej të cilëve:

Gjenerata e parë kanë përfunduar kursin bazik 302 rekrutë, të cilët kanë filluar detyrën e ushtarit nga 22 shtatori 2023 dhe gjenerata e dytë prej 326 rekrutëve janë duke vijuar SUB deri më 29 dhjetor 2023 dhe detyrën e ushtarit e fillojnë në janar të vitit 2024.

Kalimi nga grada nënoficer në gradën oficer gjithsej janë 33 pjesëtarë. Gjatë vitit 2023 janë rekrutuar 17 pjesëtarë nga personeli civil.

Gjithashtu, DPPR-ja ka hartuar: Rregulloren për rekrutimin në FSK, Rregulloren për Pastërtinë e figurës, Rregulloren për zhvillimin e karrierës në FSK dhe Rregulloren për vlerësimet vjetore në FSK. Gjatë vitit 2023 janë larguar gjithsej 221 pjesëtarë të FSK-së aktiv, rezervë dhe nëpunës civil, meshkuj 210 dhe femra 11.



ARSIMIMI DHE STËRVITJA: SHTYLLA KRYESORE E PROFESIONALIZMIT NË FSK

Arsimimi dhe Stërvitja e pjesëtarëve të FSK-së dhe MM-së brenda dhe jashtë vendit për vitin 2023 është realizuar sipas planit.

Shkollime për këtë vit në QSU janë duke i ndjekur 59 kadetë, në Akademitë Ushtarake jashtë vendit janë duke i ndjekur shkollime 57 kadetë.

Gjatë vitit 2023 jashtë vendit janë mbajtur 105 trajnime, ku kanë marrë pjesë 461 pjesëtarë apo zyrtarë. Në trajnime të brendshme kanë marrë pjesë 6622 pjesëtarë në 208 trajnime apo kurse të ndryshme. Janë realizuar 7 gara të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, ku kanë marrë pjesë 111 pjesëtarë.



MBIKËQYRJA EFEKTIVE E DETYRIMEVE LIGJORE DHE OPERACIONALE NË MM DHE FSK

Fokusi i Inspektoratit Gjeneral gjatë vitit 2023, ka qenë realizimi i Planit vjetor të veprimit, bazuar në qëllimet strategjike dhe objektivat operacionale të ministrit të Mbrojtjes.

Po ashtu, ka vazhduar mbajtja dhe ngritja e bashkëpunimit me institucionet e tjera vendore dhe ndërkombëtare, si dhe shkollën e Inspektorit Gjeneral në SHBA, me interes për MM-në dhe FSK-në në fushën e Inspektorit Gjeneral.

Sa i përket inspektimit për mbajtjen dhe ngritjen e gatishmërisë operacionale të FSK-së me njësi, është bërë monitorimi dhe inspektimi lidhur me zbatimin e programeve të mbrojtjes PPBE dhe parandalimin e abuzimit, shkaktimit të humbjeve, keq-menaxhimit në operacionet dhe programet e MM-së dhe FSK-së.

Me qëllim të zgjerimit të bashkëpunimit ndërkombëtar, Inspektori Gjeneral ka realizuar vizitë në Qendrën e LiderShipit në Koblenz të Gjermanisë dhe vizitë në bazën e Ushtrisë Amerikane për Evropë dhe Afrikë (USAREUR-AF) në Wesbaden të Gjermanisë, në zyrën e IGJ për USAREUR-AF. Në ceremoninë e ndarjes së çmimeve për Gratë e Arta të Kosovës, kryeministri i vendit, Albin Kurti ka shpërblyer gjeneral major Irfete Spahiun me çmimin "Kurora e Suksesit".



PËRPARIMET NË DOKUMENTET STRATEGJIKE TË MBROJTJES SË KOSOVËS PËR 2023

Departamenti për Politika dhe Strategji, si përgjegjës i dokumenteve strategjike, gjatë vitit 2023, ka koordinuar hartimin e Strategjisë së Mbrojtjes, duke udhëhequr grupin punues të formuar me vendim për këtë çështje.

Në mbledhjen e 143-të Qeverisë, më datë 24 maj u miratua dokumenti Strategjia e Mbrojtjes, në të cilin përcaktohen objektivat kryesore bazuar në interesat shtetërore si: Mbrojtja e sovranitetit dhe integritetit territorial të vendit, modernizimi dhe avancimi i kapaciteteve ushtarake, zgjerimi i bashkëpunimit bilateral, anëtarësimi në organizata dhe pjesëmarrja në operacione ndërkombëtare, si dhe avancimi i bashkëpunimit me NATO-n dhe mekanizmat e saj në Republikën e Kosovës, objektiva këto të cilat synohet të përmbushen në planin afatmesëm dhe afatgjatë të Ministrisë së Mbrojtjes.



Gjithashtu, janë miratuar Strategjia e MM-së për zhvillimin e PPBE-së dhe Politika Mjekësore për MM dhe FSK.

Janë përfunduar Politika e Logjistikës në MM, Politika e Infrastrukturës në MM dhe Politika për Edukimin, Vetëdijesimin dhe Ngritjen e Potencialit të Qytetarëve të Republikës së Kosovës për Shërbim në Fushën e Mbrojtjes. Ndërsa, është finalizuar Strategjia për Mbrojtje Kibernetike në MM dhe FSK.

Në muajin shkurt të këtij viti, DPS ka finalizuar dhe përcjellë punimet me analizë dhe rekomandime me titull "Busulla për siguri e mbrojtje" dhe "Greqia, kapacitetet ushtarake".

Po ashtu, janë realizuar dhe këto punime të rëndësishme me temat "Ndikimet e Luftës në Ukrainë, në NATO, BE, SHBA e në Kosovë" dhe "Veriu i Kosovës—zgjedhjet e jashtëzakonshme", "Pasqyra krahasuese e Kosovës dhe Serbisë në raport me politikat e jashtme në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes", "Personeli ushtarak dhe civil në sistemin e shërbyesve civil dhe ristrukturimi", "Emiratet e Bashkuara Arabe dhe NATO", "Republika Popullore e Bangladeshit", "Dronët të rëndësishëm në arkitekturën e mbikëqyrjes ajrore", "Përkushtimi i bashkësisë ndërkombëtare për stabilizim të Kosovës", "Republika Çeke", "Shteti Rumun", "NATO- Samiti i Vilniusit 2023", etj.

RRITJA E KAPACITETEVE TË FSK-SË PËRMES DONACIONEVE NDËRKOMBËTARE

MM dhe FSK gjatë vitit 2023 kanë pranuar donacione të llojeve të ndryshme nga vende Partnere. Donacione nga SHBA-ja në fushën e komunikimit (Cyber), EOD, automjeteve, IT dhe HAZMAT është dhënë në vlerë prej mbi katër milionë dollarë.

Gjithashtu, donacione nga Gjermania për kërkim-shpëtim, transport dhe HAZMAT janë në vlerë prej rreth 4 milionë euro.



INVESTIME TË REJA DHE PËRMIRËSIMI I KAPACITETEVE LOGJISTIKE DHE INFRASTRUKTURE PËR RRITJEN E AFTËSIVE OPERACIONALE TË FSK-SË

Që nga fillimi i vitit fiskal 2023, Departamenti i Prokurimit ka pranuar gjithsej 106 kërkesa për zhvillimin e procedurave të prokurimit, me vlerë të madhe, të mesme, të vogël dhe minimale, kurse nga viti 2022 ka pranuar 4 projekte. Departamenti i Prokurimit dhe Kontratave në total ka nënshkruar 99 kontrata. Për 10 projekte të ndryshme, me vlerë të madhe, të mesme, të vogël, janë zhvilluar procedurat e prokurimit, mirëpo janë anuluar procedurat në mungesë të ofertave të përgjegjshme ose nuk ka pranuar asnjë ofertë.

Gjatë vitit 2023 furnizime të ndryshme për nevojat e MM dhe FSK në total janë 9,937,965.12 euro ndërsa furnizime strategjike në total janë 80,000,000 euro.

Vlera e buxhetit të shpenzuar për projektet apo kontratat e planifikuara të infrastrukturës të MM dhe FSK-së për vitin 2023 është: 6,359,656.37 euro.



MM DHE FSK TË PËRKUSHTUAR NË BASHKËPUNIMIN E SHKËLQYESHËM CIVILO – USHTARAK

Me qëllim vetëdijesimin nga rreziku i mjeteve të pashpërthyer, instruktorët e FSK-së kanë mbajtur pesëdhjetë ligjërata në shkolla të mesme të larta të vendit, si dhe për vetëdijesim të rrezikut nga mjetet piroteknike, janë mbajtur shtatëmbëdhjetë ligjërata në shkolla fillore të mesme të ulëta. Në kazemat e FSK-së, janë realizuar 56 vizita të institucioneve, ndërsa në koordinim me Zyrën për Barazi Gjinore në MM, për shënimin e 8 Marsit janë realizuar disa shtëpi të të moshuarve në Prishtinë, Skenderaj, Istog. Në bashkëpunim me SHPFSK - janë koordinuar rreth 17 (shtatëmbëdhjetë) kërkesa për mbështetje nga FSK-ja (MUAC).

Gjatë vitit 2023 janë arritur dhe nënshkruar gjashtë Marrëveshje Memorandume të Bashkëpunimit/Mirëkuptimit, me institucione, shoqata dhe grupe të interesit: Marrëveshje Donacioni ndërmjet MM dhe "Islamic Relief Kosovo", Memorandum të Bashkëpunimit në mes MM dhe AKB, Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes dhe z. Azem Berisha (Pronar i tokës me Nr. Parcele 172/2), me 24.08.2023 deri me 31.12.2024. LETTER OF AGREEMENT Air Navigation Services Agency and Ministry of Defense, Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet MM dhe Liridonë Binakaj, komuna e Gjakovës, (UF) "DEFF 23", me 06.07.2023. Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes dhe komunës së Gjilanit, për iniciimin e procedurave të shpronësimit të parcelave përkatëse prona të QRK-së dhe të komunës së Gjilanit, në Kazermën "New Born" të FSK-së në Gjilan.

Ndërsa, në proces janë shtatë draft marrëveshje të bashkëpunimit: Marrëveshja teknike ndërmjet Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë, (EULEX) dhe Ministrisë së Mbrojtjes së Kosovës (MM), (për shfrytëzimin e poligonit të qitjes në Cernushë). Memorandum bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ministrisë të Punëve të Brendshme, (Qëllimi i këtij Memorandum të Bashkëpunimit është rritja e bashkëpunimit reciprok në mes të MM/FSK-së dhe MPB, përkatësisht Akademisë së Kosovës për Siguri Publike (AKSP), në ngritjen, trajnimin dhe zhvillimin e kapaciteteve të personelit të MM dhe FSK-së, dhe të personelit të MPB (PK dhe AKSP-së). Draft Marrëveshja e Bashkëpunimit me Fakultetin e Edukimit Fizik dhe Sportit - draft i hartuar i cili është duke u shqyrtuar në nivele të ndryshme në MM dhe FSK. Draft Marrëveshja e Bashkëpunimit me "New York School of Science in Kosova – edhe ky draft është duke u analizuar dhe shqyrtuar ende në MM/FSK. Draft –Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet MM/FSK-së dhe Oda e Farmacistëve të Kosovës (OFK).



REALIZIM I SUKSESSHËM I AKTIVITETEVE TË PARAPARA NË PLANIN VJETOR TË PUNËS PËR MM-NË

Bazuar në objektivat strategjikë vjetore të Ministrit të Mbrojtjes për vitin 2023 dhe dokumentet tjera relevante, është koordinuar hartimi i Planit të Ministrisë së Mbrojtjes 2021-2023, ndërsa bazuar në Programin Qeveritar 2021-2025 të Qeverisë së Kosovës, është hartuar edhe Plani i punës për Qeverinë e Republikës së Kosovës nga fushëveprimi i Ministrisë së Mbrojtjes.

Gjithashtu, është vlerësuar progresi i bërë nga MM-ja për periudha të caktuara për nivelin e përmbushjes së objektivave të lidërshit të Ministrisë së Mbrojtjes, si dhe është hartuar dhe miratuar Udhëzuesi për planifikim, vlerësim, raportim dhe menaxhim të rreziqeve në MM si dhe janë evidentuar rreziqet e mundshme.

Gjithashtu, Departamenti për Planifikim dhe Vlerësim ka përfaqësuar Ministrinë e Mbrojtjes në Komisionin qeveritar për persona të zhdukur gjatë luftës në Kosovë, ku është dhënë kontribut në realizimin e misionit.



FSK ME RITJE PROFESIONALE DHE MODERNIZIM TË PAJISJEVE

Ushtria jonë çdo ditë e më shumë po konsolidohet jo vetëm në aspektin e kuadrove profesionale por dhe furnizimin me pajisjet më moderne ushtarake. Dronët Bajraktar TB-2, të cilët u përuruan nga ana e kryeministrit Kurti, ministrit Mehaj dhe gjeneral Jasharit, janë vetëm disa nga pajisjet e blera për të forcuar ushtrinë tonë.

Departamenti i Transformimit, Modernizimit, Standardizimit gjatë vitit 2023 ka realizuar aktivitete dhe detyra bazuar në Planin vjetor të veprimit, Planin vjetor në mbështetje të PGJT, si dhe aktivitete të tjera si në vijim: Përgatitja e Planit vjetor në mbështetje të PGJT-së për vitin 2023 (A+5), monitorimi gjatë tërë vitit dhe është raportuar në baza periodike lidhur me zbatimin tij. Është hartuar drafti i parë i Politikës së modernizimit. Është miratuar Strategjia e MM-së për zhvillimin e PPBE-dhe është bërë përgatitja dhe dërgimi i vlerësimeve vjetore për personelin ushtarak për vitin 2023. Pjesëmarrja në grupe punuese me ISG, G5/8 SHPFK, si dhe në grupin punues për hartimin e konceptit për komponentin rezervë të FSK-së. Pjesëmarrje në trajnime të organizuara nga ODC, NALT, IKAP, KDS dhe në TTX.



EFIKASITETI I MENAXHIMIT TË DOKUMENTEVE NË VITIN 2023

Departamenti për Menaxhimin e Dokumenteve dhe Arkivit ka realizuar aktivitetet e saj me efikasitet të plotë. Sektori për Administrimin e Dokumenteve në Librin Kryesor të Protokollit ka trajtuar 4141 dokumente të ndryshme, ndërsa në Librin e Protokollit në Hyrje ka trajtuar 3469 dokumente. Zyra për Menaxhimin e Informacionit të Klasifikuar në Librin e Protokollit për informata të klasifikuara ka trajtuar 837 dokumente.



KUSHTET LIGJORE DHE TRANSPARENCA PËR FUNKSIONIM EFIKAS

Gjatë vitit 2023, lidhshipi i Ministrisë së Mbrojtjes ka pasur ndër prioritetet e saj përmbushjen e programit legjislativ dhe hartimin e akteve nënligjore, sipas planit legjislativ të akteve nënligjore të MM për vitin 2023. Departamenti Ligjor, sipas Planit të veprimit 2023, Programit legjislativ të Qeverisë, Planit legjislativ të akteve nënligjore ka realizuar këto aktivitete:

Gjatë vitit 2023 është miratuar Projektligji për Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes. Po ashtu është proceduar Projektligji për Statusin, Qëndrimin e Përkohshëm dhe Kalimin Transit të Forcave të Huaja të Armatosura në Territorin e Republikës së Kosovës dhe janë miratuar 15 akte nënligjore. Sa i përket bashkëpunimit dhe koordinimi me Avokatin Shtetëror, në përgatitjen e lëndëve për përfaqësim dhe mbrojtje gjyqësore në të cilat MM dhe FSK është palë ndërgjyqësi, si dhe institucionet e tjera respektive për çështje që bartin implikime ligjore për vitin 2023, gjithsej të trajtuara 43 lëndë gjyqësore.



SIGURIA KIBERNETIKE NË FOKUS: MBËSHTETJE NDËRKOMBËTARE PËR HARTIMIN E KURRIKULËS PËR QENDRËN SHETËTËRORE TRAJNUJES PËR SIGURI KIBERNETIKE

Më mbështetjen e DCAF me ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë, të financuar nga Ambasada Britanike janë organizuar tri punëtori për hartimin e kurrikulës trajnuese për siguri kibernetike me pjesëmarrës nga institucionet e QRKS dhe disa nga institucionet private që kanë në pronësi infrastrukturë kritike kombëtare. Gjatë këtyre punëtorive është hartuar kurrikula trajnuese.

Gjithashtu është bërë plotësim-ndryshimi i Strategjisë për siguri kibernetike në MM dhe FSK dhe hartimi i Planit të veprimt 2023-2024.

Është bërë harmonizimi i objektivave strategjikë dhe specifikë në Strategjinë për siguri kibernetike në MM dhe FSK krahas hartimit të Strategjisë shtetërore për siguri kibernetike.

Gjatë këtij viti në kuadër të projektit të modernizimit të sistemit të TI-së dhe sigurisë kibernetike janë pranuar pajisje dhe softuer në vlerë 3 milionë dollarë donacion nga ShBA.

Është lidhur kontrata dhe po vazhdon implementimi i Sistemit të Menaxhimit të Informacionit sipas planit për implementimin e sistemit. Deri më tani kanë përfunduar dy module: moduli për burime njerëzore dhe moduli për politika dhe plane.

Janë përgatitur në vazhdimësi materiale të ndryshme për ngritjen e vetëdijes për rreziqet në fushën e sigurisë kibernetike ku është mbajtur punëtori dy-ditore me ligjërata lidhur me vetëdijesimin e personelit të MM dhe FSK për rreziqet në fushën e sigurisë kibernetike.



AVANCIMI I KAPACITETEVE MJEKËSORE NË FSK PËRMES BASHKËPUNIMIT ME INSTITUCIONET VENDORE DHE NDËRKOMBËTARE

Në këtë vit janë miratuar dokumentet "Politika mjekësore" për MM-në dhe FSK-në "Koncepti mbi shëndetin mendor dhe mirëqenien e personelit në MM dhe FSK".

Sa i përket bashkëpunimit me institucionet vendore në fushën e mjekësisë, është nënshkruar Protokoli i bashkëpunimit në fushën e mjekësisë ndërmjet MM-së dhe Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës (SHSKUK-së), si dhe është nënshkruar Protokoli i bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural / Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë së Kosovës (AUVK).

Gjithashtu, në kuadër të planit bilateral është nënshkruar Protokoli i bashkëpunimit në fushën e mjekësisë ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes së Kosovës dhe Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Italisë.

Gjatë këtij viti është arritur marrëveshje bashkëpunimi me Qendrën Psiko-Sociale për Trauma-terapi, OJQ "Diaconie" Kosova.

Në kuadër të Bashkëpunimit ndërkombëtar, me ushtrinë turke ka vazhduar dërgimi i pacientëve për trajtim mjekësor në GATA- Ankara.



BASHKËPUNIMI I MIRË ME QENDRËN KOMBËTARE TË TRANSFUZIONIT TË GJAKUT KA VAZHDUAR EDHE NË VITIN 2023

Në kuadër të këtij bashkëpunimi janë organizuar aksionet e dhurimit vullnetar të gjakut në MM dhe FSK. Aktiviteti tashmë tradicional i dhurimit vullnetar të gjakut në Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK është mbajtur në dy sesione, ku personeli civil dhe ushtarak i Ministrisë së Mbrojtjes i është përgjigjur pozitivisht këtij aksioni.

SHËRBI MI I INTELIGJENCËS DHE SIGURISË GARANCI PËR FUNKSIONIMIN E MM-SË DHE OPERACIONALITETIN EFIKAS TË FSK-SË

Me qëllim të implementimit të politikave të sigurisë, realizimit të objektivave të Ministrit të Mbrojtjes, dhe aktiviteteve të planifikuara me PVP 2023, Drejtoria e Inteligjencës dhe Sigurisë, ka vazhduar aktivitetet në realizimin, hartimin, rishikimin dhe implementimin e dokumenteve strategjike për fushën e inteligjencës dhe sigurisë.

Ngritja e nivelit të sigurisë dhe informacionit përmes realizimit të projekteve të sigurisë për MM dhe FSK (Modernizimi i sistemit të sigurisë dhe komunikimi i sigurt strategjik). Vlerësimi i gjendjes së sigurisë në MM dhe FSK përmes inspektimeve të rregullta si dhe testimet e paparalajmëruara të sigurisë në MM dhe FSK.

Gjatë vitit 2023 janë hartuar këto dokumente: draft-Ligji për Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes - AISM; Udhëzuesi për bartjen dhe përdorimin e armëve zyrtare në MM dhe FSK; Rregullore për sigurinë fizike në MM; Marrëveshja ndërshtetërore SHBA-Kosovë për sigurinë e informacionit të klasifikuar (GSOIA) dhe angazhim në mbështetje të Komisionit qeveritar për hetimet aeronautike.



MINISTRIA E MBROJTJES ME RITJE TE BUXHETIT PËR VITIN 2024

Plani buxhetor 2024-2026 i Ministrisë së Mbrojtjes, sipas kufijve buxhetor është 153 milionë euro për vitin 2024. Po ashtu, gjatë vitit 2023 Qeveria e Kosovës për mbështetjen e blerjeve të pajisjeve të FSK-së ka ndarë buxhet shtesë për MM/FSK, mbi 38 milionë euro apo 31% nga buxheti i aprovuar.

Për vitin 2023, buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes ishte 123,227,260. 87 euro. Është ekzekutuar buxheti për vitin 2023, deri në përfundim të muajit nëntor buxheti është realizuar mbi 74% të buxhetit aktual mbi 161 milionë euro.

PËRFAQËSIMI I GRAVE DHE VAJZAVE NË MM DHE FSK ME PRANI STANDARDE TË KRAHASUAR ME VENDET E RAJONIT DHE NATO-S

Niveli i përfaqësimit të grave dhe vajzave në MM dhe FSK si në pikëpamje numerike ashtu edhe cilësore, me prani standarde të grave dhe vajzave, krahasuar me vendet e rajonit dhe NATO-s. Komunitetet dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë që lirisht të kultivojnë, shprehin dhe zhvillojnë kulturën dhe identitetin e tyre dhe të ruajnë e përmirësojnë elementet esenciale të identitetit të tyre, veçanërisht gjuhën, traditat, fenë dhe trashëgiminë e tyre kulturore. Ministria e Mbrojtjes dhe Forca e Sigurisë së Kosovës, ka përmbushur obligimin për punësimin e personave me aftësi të kufizuara, i cili përcaktohet sipas Ligjit për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara. Me qëllim të ngritjes së transparencës, mundësive të barabarta dhe jo diskriminuese për të gjithë pa dallim gjinie dhe etnie, gjatë procesit të rekrutimit të ushtarëve, kadetëve për QSU dhe akademitë tjera jashtë vendit gjatë vitit 2023, Ministria e Mbrojtjes përmes mekanizmave të saj, duke përfshirë edhe këshilltarët NALT-it, kanë monitoruar në cilësi të vëzhguesit procesin e rekrutimit për përzgjedhjen e rekrutëve të rinj të FSK-së për vitin 2023.



IMPLEMENTIMI I STRATEGJISË PËR INTEGRIMIN E KOMUNITETEVE JO-SHUMICË

Strategjia për Integrimin e Komuniteteve Jo-Shumicë, e implementuar në vitin 2023 ofron kahje strategjike për integrim të qëndrueshëm të komuniteteve jo-shumicë në MM. Me qëllim të informimit të këtyre komuniteteve për hapjen e konkurseve, si për kadetë ashtu dhe për rekrutë, gjatë vitit 2023 janë realizuar takime me përfaqësuesit e institucioneve, organizatave joqeveritare, me përfaqësuesit e komunave të Republikës së Kosovës të banuara me komunitete jo shumicë.

Po ashtu, janë zhvilluar aktivitete me Ministrinë për Komunitete dhe Kthim, zyrat për çështje të komuniteteve në komunat e Republikës së Kosovës, me qëllim informimin e të rinjve të interesuar për t'u bërë pjesë e FSK-së.

Lidhur me identifikimin e vështirësive eventuale, me qëllim të monitorimit dhe integritit të qëndrueshëm të komuniteteve, sipas Ligjit për të drejtat e komuniteteve pakicë, Njësia për Çështje të Komuniteteve ka mbajtur takime të rregullta me komunitete jo shumicë në të gjitha komandat dhe njësitë e FSK-së.



PROFESIONALIZËM DHE OBJEKTIVITET NË KOMUNIKIMIN ME PUBLIKUN DHE MEDIAT

Përkushtimi maksimal ndaj komunikimit profesional dhe transparent me publikun ka vazhduar dhe në vitin 2023. Të gjitha aktivitetet publike dhe mediale të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së, janë paraqitur me angazhim dhe profesionalizëm të lartë.

Gjatë këtij viti, ZMP ka organizuar katër konferenca për media, ka publikuar 588 postime në rrjete sociale, 110 komunikata për media dhe janë realizuar 29 video të ndryshme, sipas planit të veprimit mediatik të ZMP-së dhe MM-së.

Gjithashtu, për rekrutimin e kadetëve të rinj të FSK-së, janë realizuar dy fushata të suksesshme mediatike.



PROTOKOLLI INSTITUCIONAL DHE SHTETËROR I NIVELIT TË LARTË



Njësia e Protokollit gjatë vitit 2023 ka realizuar aktivitetet e saj me efikasitet të plotë siç janë aktivitetet e planifikuara, aktivitetet sipas kërkesave lidhur me organizimin e pritjeve të autoritetet ndërkombëtare gjatë vizitave të tyre në MM dhe FSK, si dhe harmonizimin dhe koordinimin e vizitave në MM dhe Shtabin e Përgjithshëm të FSK-së.

Disa nga aktivitetet kryesore të organizuara nga Njësia e Protokollit për këtë vit janë: pjesëmarrja në organizimin e ceremonisë së paradës ushtarake për shënimin e 15- vjetorit të Pavarësisë së Republikës së Kosovës, e organizuar në sheshin „Zahir Pajaziti”, pjesëmarrja në organizimin dhe mbarëvajtjen e ceremonisë ushtarake për shënimin e 25- vjetorit të Epopesë së UÇK-së, pastaj pjesëmarrja në ceremoninë e realizuar në kazermën „Adem Jashari” nën patronazhin e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, më datat 5, 6 dhe 7 Mars, etj.

Gjithashtu, gjatë këtij viti Njësia e Protokollit ka marrë pjesë në organizimin e ceremonive ushtarake, konferencave, seminareve dhe agjendave protokollare, sipas nevojave dhe kërkesave për pritjen e delegacioneve të larta ndërkombëtare me ceremoni ushtarake.



VITI I SUKSESEVE TË USHTRISË





Publikues:
Drejtoria për Politika të Mbrojtjes
Departamenti për Planifikim dhe Vlerësim
Zyra për Marrëdhënie me Publikun